



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1798 / Prot.

Patos, më 17/07 2025

3.1

PROCESVERBALI I TAKIMIT 16 KORRIK 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 09:30

Ora e mbarimit: 10:30

Dëgjuesë publike me temë: “Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës nr. 1675 prot., datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli , Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Përfqësues nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit., *rreth 36 pjesëmarrës (kryetarë të fshatrave, përfaqësues të banorëve të qytetit të Patosit, përfaqësues të institucioneve publike dhe jopublike, ASHP etj).*

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetar i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjuesë publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1675 prot., datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit për zhvillimin e dëgjësës publike lidhur me Planin Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030, sot jemi mbledhur për të marr komentet dhe rekomandimet lidhur me draft planin e hartuar për bashkinë Patos. Ju ftoj të gjithëve të ndiqni prezantimin e përfaqësuesve të bashkisë dhe jemi të hapur për të marr komentet dhe rekomandimet tuaja.

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli– përshëndetje të gjithëve! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë e kësaj dëgjese publike dhe keni gjetur kohën për të sjell rekomandimet tuaja lidhur me Planin Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030.



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
Znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj-përshëndetje të gjithëve!



**Drejtor
z. Çajup Refitaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

Do të prezantojmë Planin e Menaxhimit të Mbetjeve pasi është një element kryesor i bashkisë Patos. Do të ketë edhe ndërhyrje në këtë plan pasi do të merren parasysh edhe direktivat nga BE lidhur me trajtimin e mbetjeve në bashkinë Patos. Këtë plan e kemi ndërtuar duke u mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi duke ndarë atë në elementë kryesore

siç janë objektivat e planit, metodologjia, qëllimi etj. Natyrisht planet dhe puna jonë është prekur nga të gjithë ju. Ne kemi filluar me një projekt që është vazhduar në lagjen Grizë-Lënginas që është quajtur "Kosha të personalizuar" dhe po vazhdohet me tej në lagje të tjera. Qëllimi është që të kemi një ambjent sa më të pastër. Sigurisht që ky plan ka një kosto për zbatimin e tij dhe ne jemi mbështetur duke parë edhe gjithë elementët e koston në këtë material duke filluar nga kostot direkte, variable dhe kostot fikse që shoqërojnë këtë shërbim. Natyrisht kjo kosto do të jetë e ndryshueshme dhe nuk është fikse.

Elementët kryesor kanë të bëjnë me përshkrimin e gjendjes ekzistuese, hartimin e objektivave, hartimin e planit të veprimit dhe llogaritë e kostove. Gjendja ekzistuese e prekëm duke prezantuar edhe kontenierët dhe koshat individual. Një nga objektivat kryesor është ndarja e mbetjeve. Kjo ndarje do sigurojë që këto më pas të trajtohen duke pasur edhe një prekje ekonomike. Kjo mund të bëhet me anë të riciklimit ku mbetjet mund të shërbejnë edhe në industri. Më pas do të vazhdojmë me projekte të tipit ku do të bëhet ndarja mbi përbërjen e bazës së tyre e cila do të siguronte një vlefshëmëri ekonomike. Të ardhurat që do të mund të sigurohen nga kjo ekonomi, pra me të ardhurat nga industria do ta shikojmë në pjesën e lehtësimit të kostove për banorë. Një informacion i përgjithshëm mbi bashkinë lidhet me faktin se bashkia ka tre njësi administrative dhe territori i bashkisë Patos shtrihet kryesisht në zonën naftëmbajtëse të Patos- Marinzës e cila përbën një burim natyror shumë të rëndësishëm që ne kemi si bashki dhe një potencial i madh zhvillimi ekonomik që siguron dhe të ardhura. Shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ne e kemi menaxhur mbi vet strukturën që ka ndërtuar bashkia Patos në Agjencinë e Shërbimeve Publike që ofron shërbimin e pastrimit në të gjithë territorin e bashkisë. Për këtë ne kemi statistika për një sasi vjetore të mbetjeve që ne krijojmë, e cila është 3848.19 ton të mbeturinave në vit. Kemi bërë edhe një përllogaritje në zonat urbane e cila shkon nga 0.8 deri në 0.9 kg për banorë, ndërsa në zonat rurale kjo shkon nga 0.4 në 0.7 kg/ banorë. Mbetjet hidhen të padiferencuar dhe kjo është sfida për këtë vit. Në territorin e bashkisë Patos janë shpërndarë 385 kontenier që kanë një kapacitet mbajtës 1.1 m³ dhe kosha plastik nga 1100 L dhe 15 kontenjer plastik 770 L, 15 kontenjer 660 L dhe 283 kontenjer plastik 120L. Bashkia Patos çdo vit blen kontenjer të rinj për të zvendësuar ata që dëmtohen. Sasia e mbetjeve nga bashkia Patos dërgohet në incenerator dhe është 13.5 km larg. Pastrimi në njësitë Zharrëz dhe Ruzhdie bëhet nga dy herë në javë. Zonat rurale kanë një gjenerim më të vogël të mbetjeve. Shërbimi i pastrimit të rrugëve është i ndarë sipas lagjeve. Stafi që realizon këto detyra janë ata të Agjencisë së Shërbimeve Publike. Objektivat lidhen me konsolidimin e shërbimit në zonat që ofrohet shërbimi i pastrimit të mbetjeve duke rritur cilësinë e shërbimit dhe ta shtrij shërbimin në

zonat që nuk ofrohet shërbim. Ngritja dhe forcimi i sistemit të ndarjes së mbetjeve në burim, zgjerimi i shërbimit nga 80% në 100%, përmirësimi i mbledhjes së tarifës financiare të shërbimit. Reduktimi i ndotjes mjedisore dhe mbrojtja e burimeve natyrore është një tjetër objektiv. Zhvillimi dhe bashkëpunimi me shkollat në edukimin e brezave që të kemi qytetarë sa më të edukuar dhe përfshirja e inovacitë në riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve që të ulët dhe niveli i ndotjes. Të promovojmë një ekonomi qarkore dhe të rrisin riciklimin si dhe duke krijuar mundësi ekonomike nëpërmjet përfshirjes së komunitet, biznesit dhe qytetarëve në praktika.

Skenarët e ndarjes së mbeturinave në dy rryma kryesore në zonat pilot për tu shtrirë fillimisht janë njësitë administrative Zharrëz dhe Ruzhdië. Kjo bëhet duke i klasifikuar ato në të riciklueshme dhe të pariciklueshme në mënyrë që të bëhet transmetimi i tyre në industri që i përdorin këto si lëndë të para. Të pariciklueshmet do të jenë objekt për tu sistemuar dhe grumbulluar. Edhe në shkolla do të përdoren koshat ndarës duke bërë edhe edukimin e brezave në hedhjen e mbeturinave. Komponentët kryesor të kostos së këtij shërbimi ne i kemi parë dhe kemi bërë një analizë duke i ndarë në kosto variable dhe fikse. Variable është ajo që shoqëron gjithë zërat e shpenzimeve që i referohen këtoj shërbimi drejtëpërdrejtë nga pakat e personelit, mjetet që janë në mbështetje të këtij shërbimi etj. Kostot janë ndarë edhe në bazë zonash pasi do futen edhe sasia e karburantit për zonat që janë më larg. Plani i veprimit konsiston në mbledhjen e mbetjeve urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet. Ne ofrojmë edhe dezinfektimi i vendeve ku përdoren kontenjerët. Në këtë 5 vjeçar është parashikur që ky shërbim të ofrohet nga ASHP dhe do koordinohet nga aktorët përgjegjës. Gjithashtu do monitorohet nga bashkia dhe ASHP do të dërhojë të dhëna teknike dhe financiare lidhur me zbatimin e këtij Plani dhe çdo aktivitet të ndërmarr.

Kryetar i Fshatit të Ri z. Bexhet Rredhi- Përhëndetje! Në fshatin tonë janë vetëm dy kosha mbeturinash. Një prej tyre është të shkolla dhe tjetri ndodhet në fund të lagjes që del



**Kryetar i Fshatit të Ri
z. Bexhet Rredhi**

Dëgjësë publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

nga Frashëri. Çfarë masash do të ndërmerren për koshat sepse dalin mbeturinat dhe fshati ka nevojë për më shumë kosha.

Drejtore i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj- Në



**Drejtore
z. Çajup Refitaj**


Dëgjesë publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

këtë plan në prezantuar mbi shërbimin që ofrojmë dhe brenda këtij 5 vjeçari ky shërbim do të shtrihet në të gjitha zonat. Zharrëza do të fillojë e para pasi do të shërbejë edhe si njësi pilot për shtrimin e këtij shërbimi.

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Novruz Toska- përshëndetje! Çfarë kupton me koshat e personalizuar? Unë kam një sugjerim dhe një konstatim. Bashkia ka bërë një punë të mirë në



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Novruz Toska**

Dëgjesë publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

menaxhimin e mbetjeve. Unë mendoj edhe si banor dhe si anëtarë i Këshillit Bashkiak që bashkia Patos duhet të vihet në pararojë në bashkitë e Republikës për menaxhimin e mbetjeve. Bashkia Patos ka një popull të kulturuar dhe mendoj që ne duhet të hedhim hapa të shpejta për mberurinat. Ne duhet të diferencojmë mbetjet që në burim dhe kështu do të tregojmë kulturën tonë. Duhet të flitet në shkollë, në komunitet dhe në çdo vend. Ne duhet të synojmë të përdorim koshat për diferencimin e mbetjeve që edhe të kapim standardet e Europës pasi këto të gjitha janë në të mirë të komunitetit. Unë mendoj që kjo duhet të merret parasysh dhe strukturat e pushtetit vendor dhe qendror duhet të flasim më fortë në menaxhimin e mbetjeve duke përcjellë kulturë. Në lagjen time janë tre kosha dhe unë kam parë edhe njerëz që i

hedhin mbeturinat në tokë dhe jo në kosha. Bashkia duhet të ndërhyjë në edukimin e popullsisë.

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj- Do të



**Drejtor
z. Çajup Refitaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

thotë që secila nga familjet do të ketë nga një kosh në banesë të cilin do të përdori për hedhjen e mbeturinave. Sugjerimi juaj është i drejtë dhe të gjithë banorët duhet të ndërgjegjësohen. Ne do ti referohemi stimujve ku secili që do bëj ndarjen do rishikojmë tarifat e tyre. Mjedisi është element shumë i rëndësishëm.

Zv/ Kryetar e bashkisë, znj. Ina Sauli- Doja tyë shtoja që ndarja në burim po aplikohet në disa shkolla qyteti që është futur si edukim i brezave dhe menaxhim i mbetjeve. Një



**Zv/ Kryetar e bashkisë
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

indikatorë tjetër është që do vendosim si kriter edhe performancën e pagesës së taksave në ato zona ku do aplikohet shërbimi. Normalisht zonat që paguajnë taksat duhet tu ofrohet dhe shërbimi.

Kryetar i fshatit Kuqar, znj. Islam Shpata- Përshëndetje! Dua të di nëse ka masa ndëshkuese apo kujt mund ti adresohemi me ankesë lidhur me personat që hedhin mbetje të ngurta, gur, pemë të prera në koshat e mbeturinave.



**Kryetar i fshatit Kuqar
znj. Islam Shpata**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”

Korrik 2025

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj-



**Drejtor
z. Çajup Refitaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”

Korrik 2025

Mbetjet e ngurta nuk janë pjesë që i mbulojmë ne sepse dalin nga riparimet e objekteve ekzistuese. Banorët duhet të marrin masa për ti sistemuar mbetjet dhe jo të gjejnë rrugën e shkurtër për ti hedhur në koshin e mbeturinave. Koshat janë për tu përdorur për mbetjet ushqimore të familjeve.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Ju duhet të lajmëroni Policinë



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”

Korrik 2025

Bashkia dhe bashkia do të ndërhyj me anë të vendosjes së masave administrative lidhur me këtë problem.

Përgjegjëse e Sektorit të Mjedisit, znj. Blerina Laçi- Bashkia ka si funksion menaxhimin e mbetjeve të urta urbane që janë të riciklueshme. Mbetjet bujqësore kanë volum dhe nuk mund



**Përgjegjëse e Sektorit të Mjedisit
znj. Blerina Laçi**

Dëgjesë publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

të hidhen në koshat e bashkisë, por mund të kompostohen në kopshtin e tyre apo të njoftohet bashkia. Duke u mbushur me të tilla mbetje dhe inceneratori nuk i pranon këto mbetje.

Kryetar i fshatit Rusinj, z. Ajet Bregu- Te ne kanë vendosur dy kosha dhe i kanë lënë pa bazament. Kur do vendoset bazamenti?



**Kryetar i fshatit Rusinj
z. Ajet Bregu**

Dëgjesë publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli- Është duke u punuar nga ASHP për krijimin e të



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

gjithë bazamenteve dhe do të ndërtohen së shpejti.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Nëse ju nuk keni komente, pyetje apo rekomandime të tjera unë e dakloroj të mbyllur këtë dëgjese publike. Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe shihemi në dëgjesa të tjera.



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Plani Lokal i Menaxhimit të
Integruar të Mbetjeve 2025-2030”**

Korrik 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba